

Më 7 Gusht 2017 përmbaruesi gjyqësor privat z.Altin Vako ka lëshuar Urdher per venien e sekuestros konservative mbi te drejtat qe lindin nga Marrëveshja Hidrokarbure për Vendburimin Ballsh-Hekal. Në po të njëjtën ditë përmbaruesi depoziton në Qendrën Kombëtare të Biznesit shkresën “Njoftim i debitorit për shkresën Nr. 738 Prot, datë 7.08.2017 nëpërmjet afishimit pranë QKB” ka përcjellë të bashkëlidhur urdhërin e sekuestros.

Pas marrjes së raportit të ekspertit lidhur me vlerën e tregut të të drejtave të Paditësit në bazë të Marrëveshjes Hidrokarbure, Përmbaruesi gjyqësor nxorri një njoftim për shitjen e sendit të luajtshëm në ankand, për vlerën prej 1,000,911.20 USD.

Më datë 19 Shtator 2017 Përmbaruesi organizoi ankandin por asnjë ofertues nuk u paraqit. Si rrjedhojë më datë 26 Shtator 2017 u zhvillua një ankand i dytë në të cilën u paraqit vetëm një ofertues shoqëria “Anio Oil and Gas” sh.a, i cili u shpall fitues për të drejtat e Marrëveshjes Hidrokarbure për një vlerë prej **700,692 USD**.

Më datë 28 shtator 2107, Z.Vako njoftoi Albpetrol-in për udhërin e tij mbi kalimin e të gjithë të drejtave në lidhje me Marrëveshjen Hidrokarbure të Vendburimit të Ballshit nga shoqëria TransAtlantic Albania ltd tek shoqëria “Anio Oil and Gas” sh.a, e cila u shpall fituese e ankandit të dytë.

Nga njoftimi i përmbaruesit si më sipër, në vijim është zhvilluar komunikimi si vijon, lidhur me transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të Marrëveshjes Hidrokarbure për Vendburimin Ballsh-Hekal:

1. Shkresa e Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako me Nr.6443 Prot., datë 28.09.2017, me lëndë “Kërkesë për kalimin e të drejtave të lindura nga “Marrëveshja Hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendurimin Ballsh-Hekal” datë 19.07.2007, lidhur midis shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe shoqërisë Stream Oil&Gas limited.” – drejtuar Albpetrol sh.a.
2. Shkresa e AKBN me Nr.6944 Prot., datë 18.10.2017, me lëndë “Kërkohet mendimi i Albpetrol për kërkesën e përmbaruesit privat” - drejtuar Albpetrol sh.a.

3. Shkresa e Albpetrol me Nr.6944/1 Prot., datë 18.10.2017 me lëndë “Mbi shqyrtimin në Këshillin Teknik Shkencor të Albpetrol sh.a., të kërkesës së shoqërisë Anio Oil&Gas sh.a. lidhur me vendburimin Ballsh-Hekal” – drejtuar Anio Oil&Gas sh.a.
4. Shkresa e Albpetrol me Nr.6710 Prot., datë 20.10.2017 me lëndë “Rekomandimet e Këshillit Tekniko-Shkencor” – drejtuar Administratorit të Albpetrol sh.a.
5. Shkresa e Anio me Nr.7010 Prot., datë 20.10.2017, me lëndë “Shkresë përcjellëse për dorëzim dokumentacioni shoqërisë Albpetrol sh.a.” – drejtuar Albpetrol sh.a.
6. Shkresa e Albpetrol me Nr.6944/2 Prot., datë 20.10.2017 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës tuaj me Nr.6886/2 Prot., datë 17.10.2017” – drejtuar AKBN
7. Shkresa e MIE me Nr.389 Prot., datë 17.01.2018, me lëndë “Ju përcjellim për njohje dhe zbatim Urdhërin e Ministrit Nr.02, datë 03.01.2018” – drejtuar Albpetrol sh.a. – AKBN
8. Shkresa e Anio me Nr.374 Prot., datë 17.01.2018, me lëndë “Miratimi i kalimit të të drejtave të Licencë Marrëveshjes për vendburimin e Ballsh-Hekal lidhur ndërmjet Ministrisë së Tregtisë dhe Energjitikës e përfaqësuar nga AKBN dhe Albpetrol sh.a. e datës 04.07.2007” – drejtuar AKBN, për dijeni Albpetrol sh.a. – MIE
9. MEMO e Grupit të Punës, datë 17.01.2018, me lëndë “Raport i Grupit të Punës të ngritur me Urdhër të Ministrit 02, datë 03.01.2018” – drejtuar MIE
10. Shkresa e AKBN me Nr.592 Prot., datë 24.01.2018, me lëndë “Kërkesë për informacion” – drejtuar Albpetrol sh.a.
11. Shkresa e Albpetrol sh.a. me Nr.592/1 Prot., datë 24.01.2018 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës tuaj me Nr.745/1 Prot., datë 22.01.2018” – drejtuar AKBN
12. Shkresa e Albpetrol me Nr.592/2 Prot., datë 31.01.2018 me lëndë “Në vijim të shkresës tonë me Nr.592/1 Prot., datë 24.01.2018” – drejtuar AKBN
13. Shkresa e Anio me Nr.592/3 Prot., datë 15.02.2018 me lëndë “Dorëzim dokumnta shtesë për shoqërinë Anio Oil&Gas dhe Letho Resources Corp” – drejtuar AKBN – për dijeni Albpetrol – MIE
14. Shkresa e Anio me Nr.1964 Prot., datë 01.03.2018, me lëndë “Kërkesë për miratimin e kalimit të interesave të Licencë Marrëveshjes sipas Instrumentit të

Transferimit nënshkruar midis shoqërisë Albpetrol dhe Anio Oil&Gas sh.a.” – drejtuar MIE – për dijeni AKBN – Albpetrol sh.a. – Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

- 15.Shkresa e AKBN me Nr.2334 Prot., datë 13.03.2018, me lëndë “Përgjigje lidhur me shkresën tuaj me Nr.03/18 Prot., datë 01.03.2018 – drejtuar ANIO – për dijeni Albpetrol sh.a. – MIE - Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- 16.Shkresa e Anio me Nr.3088 Prot., datë 05.04.2018, me lëndë “Kthim përgjigje” – drejtuar AKBN – për dijeni MIE - Albpetrol sh.a. – Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
- 17.Shkresa e Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako, datë 07.05.2018, me lëndë “Për prezencë, mbështetje dhe ndihmë të përmbaruesit gjyqësor privat në ekzekutimin e një titulli ekzekutiv” – drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier – për dijeni TransAtlantic Albania Ltd. – Anio Oil&Gas sh.a. – Albpetrol sh.a., etj (kreditorët)
- 18.Më anë të shkresës nr.506 Prot, datë 09.05.2018 (referenca në Albpetrol nr.4050 Prot, datë 10.05.2018) zAltin Vako njofton shoqërinë “Albpetrol” sh.a se AKBN-ja në datën 2.05.2018 ka nënshkruar Instrumentin e Transferimit, me anë të të cilit të drejtat dhe detyrimet sipas Marrëveshjes Hidrokarbure dhe Licencë Marrëveshjes për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Vendburimin Ballsh-Hekal i kalojnë shoqërisë “Anio Oil & Gas “ sh.a